

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Real Mineral Mining" sh.p.k.

Sot, më datë 11.08.2016, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- **Z. Sahil Goel**, shtetas Indian, lindur më 27.10.1987, banues në Kanada, mbajtës i letërnjoftimit nr. K2030906, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

Neni 1
Themeli

- 1.1 Emri i shoqërisë është "**Real Mineral Mining**" Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur "Shoqëria". Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2
Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Him Kolli" pallati 48, Tiranë.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3
Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me objekt veprimtarie si me poshtë vijon:

- A. Në industrine minerare, studim gjeologjik, kerkim, përpunimin edhe shfrytzimin e mineraleteve nëntoksore; shitje blerjen e mineraleteve si brenda vendit ashtu dhe import eksportin e tyre, duke perfshire edhe perdorimin e lendeve plasese dhe



- eksploziv per proçeset minerare si: nafta, gazi natyror, qymyrguri, krom, hekur-nikel, baker, plumb, zink, manganit, boksitit, bitium, squfur, magnez, mermer, argjile, gjips, flori, argjend etj. Ofrimin e konsulences ne fushen e minierave.
- B. Çdo veprimitari tjetër e ligjshme si zhvillimin, blerjen, shitjen dhe investimin e pronave te patundshme, hapjen e puseve, pompimin, zhytjen, rilevimin, nxjerjen dhe shfrytezimin e naftes ose te gazit natyror dhe mineraleve te cituara me lart, instalimin ose ndertimin e infrastruktureve per realizimin e ketyre veprimitarive. Te blej apo te mari si dhurate apo me qera ose me nenqera, shkembim apo cdo forme tjeter te njohur nga ligji te pronave te tundshme apo te patundshme dhe mallra te cdo lloji ,krahas veprimitarive te permendura me siper per pronat e tundshmee te patundshme te mbaj edhe te drejta, privilegje, koncesione, leje, licensa, mallra ne magazine te nevojshme per vijimin normal te biznesit. Importimin, dhenien me qera edhe riparimin e makinerive edhe pajisjeve.

3.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (Një Qind mijë lekë) dhe është i ndarë në 1 kuote të barbarta vlera nominale e të ciles është 100,000 lekë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetëm :
- **Z. Sahil Goel**, shtetas Indian, lindur më 27.10.1987, banues në Kanada, mbajtës i letërnjoftimit nr. K2030906, zotërues i një kuote të Shoqërisë, me vlerë 100,000 (Një Qind mijë lekë), duke përfaqësuar 100% (Një Qind) të kapitalit themeltar .
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

2


- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6
Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7
Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- Z. Meenakshi Goel, shtetas Indian, lindur më 07.08.1961, banuese në Kanada, mbajtës i letërnjoftimit nr. Z2890695.
- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8
Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përashtimi, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2015.



A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized 'B' or similar character, is placed here.

Neni 9
Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, miratohet nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare.

ORTAKU I VETËM

Sahil Goel

SAHIL GOEL

